



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranimat - Pranimet Me Data 22-10-2024

Nr. Dokument Orig. Brev.	Numeri Brev.	Adrepa Funksion	Vlera Vrednost
02-	035/02-		1213

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT
mes
SHOQATA E MIQËSISË KOSOVË-AUSTRI
Dhe
KOMUNA E VITISË

Për
SHËNIMIN E PËRVITSHËM TË DITËS SË
SHTETËSISË SË SHTETIT TË AUSTRIË

Tetor, 2024



Preambula

Ky memorandum i mirëkuptimit ka për qëllim sigurimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve nënshkruese. Me këtë rast, Shoqata e Miqësisë Kosovë - shpreh interesimin që të bashkëpunojnë me Komunën e Vitisë me rastin e shënimit të ditës së shtetësisë të shtetit të Austrisë, në shenjë dhe simbolik të rëndësisë së bashkëpunimit mes dy shteteve tona në lëmi të ndryshme, si dhe me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy shteteve mike.

Neni 1

Palët

Palë të këtij memorandumi janë Komuna e Vitisë dhe Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri.

Neni 2

Qëllimi

Me nënshkrimin e këtij memorandumi palët dakordohen që të bashkëpunojnë me qëllim që të zbatohet objektivi i përcaktuar i këtij memorandumi, përkatësisht shënjimi përvitshëm i Ditës së Shtetësisë së Austrisë në Komunën e Vitisë më datën 26 tetor.

Neni 3

Zotimet e palëve

Në kuadër të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Komuna e Vitisë merr përsipër zotimin që me datën e lartcekur (26 tetor) të secilit vit të ngritë në shtizë para objektit të saj (objektit të Komunës) flamurin e shtetit të Austrisë, krahas flamurit shtetëror të Kosovës, në shenjë të respektit dhe miqësisë mes dy shteteve tona.

Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri merr përsipër që me rastin e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit të bëjë dorëzimin ceremonial dhe simbolik të flamurit të Austrisë tek Kryetari i Komunës së Vitisë.

Me rastin e nënshkrimit të këtij MM, komuna e Vitisë nuk ka asnjë kosto apo obligim financiar.

Arsim VRANOVI

Avokat,
President i Shoqatës Kosovë-Austri

Sokol HALITI

Kryetar i Komunës së Vitisë

